



Prishtinë: 22.04.2013

Kodi i ZRRE-së: V_521_2013

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_916_03_13

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreu IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_916_03_13**; dhe
5. Ankesën e konsumatorit me datë 08.04.2013.

Në mbledhjen e mbajtur më 22 prill 2013, nxorri këtë:

VENDIM

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit A. J. (shifra në KEK: DGJ - 9065) nga Gjakova ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_916_03_13 i datës 18.03.2013.

Arsyetim

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 05.08.2004 kanë dalur te konsumatori dhe kanë konstatuar se konsumatori posedon njehsor 6 shifror ndërsa gjendja merret si 5 shifror; gjendja TL = 4784 kW, TU= 4042 kW, ndërsa gjendje faktike është: TL = 48343 kW dhe TU = 40866 kW. Punëtorët autorizuar të KEK-ut kanë theksuar se të faturohet dallimi kilovatëve. Pas kësaj me datë 05.10.2004 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë dalur te konsumatori me shifër DPR – 9065 dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik i konsumatorit nr. 2248588 është 5 shifror e jo 6 shifror dhe se vlera e ngarkuar duhet të shkarkohet.

Me datë 19.01.2005 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë dalur te konsumatori dhe kanë konstatuar se është keqpërdor njehsori elektrik përreth qelqit ana e djathtë poshtë me shirit filmik, qelqi është shty me forcë e pastaj është keqpërdor, është pengu puna e numëruesit, urat e tensionit janë dëmtuar, është keqpërdor njehsori elektrik për kohë shumë të gjatë me shumë vite.

Konsumatori me datë 24.03.2009 ka parashtruar ankesë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën e bërë nga KEK-u. Departamenti për Konsumator në KEK me datë 18.12.2009 i ka kthyer përgjigje konsumatorit duke i theksuar se:

- o Fatura e rikthimit të humbjeve nr. 2678 e datës 04.03.2005 në vlerë financiare prej 868.62 € mbetet si e tillë për shkak të Aktgjykimit P.nr. 403/05 nga Gjykata Komunale e cila e shpallë z. A. J. Fajtor për Harxhimin e Paautorizuar të energjisë elektrike dhe i njëjti aktgjykim e merr formën e prerë;
- o Fatura nr. 2119 e datës 07.10.2004 duhet të korrigjohet në tërësi pasi si e tillë nuk është bazuar në procesverbal të kontrollimit të njehsorit dhe për të njëjtën periudhë kohore



konsumatori është ngarkuar me energjinë e humbur e cila ka rezultuar me faturën me vlerë financiare prej 868.62 € - faturë kjo e cila është mbështetur në procesverbal të kalibrimit dhe procedurën për identifikimin e Harxhimit të paautorizuar.

- Korrigjimi prej 598.00€ në llogarinë n. 9065 duhet të ekzekutohet nga Sektori për Konsumatorë.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes nga ana e KEK-ut, ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me të cilin ka kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 18.03.2013 ka nxjerr vendim duke refuzuar pjesërisht ankesën e konsumatorit.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, më datë 08.04.2013 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, me të cilën ka kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_916_03_13 të datës 18.03.2013. Konsumatori në ankesë thekson se nga viti 1980 e deri më 2004 ka poseduar njehsorin e prodhimit "ISKRA" dhe se këtyre njehsorëve që nga pas lufta u janë ndërruar dy, tri billomba. Konsumatori në ankesë ka theksuar se për të demantuar se nuk kam keqpërdorur njehsorin elektrik është se vet kam parashtruar kërkesë për ndërrim njehsori. Edhe pas ndërrimit të njehsorit elektrik shpenzimi i energjisë elektrike ka mbetur i njëjtë.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 22.04.2013 ka shqyrtuar dhe analizuar dëshmitë e paraqitura nga konsumatori, përkatësisht kundërshtimet e konsumatorit të theksuar në ankesë ndaj vendimit të DMK-së.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar procesverbalet e KEK-ut dhe transaksionet e konsumatorit të shifrës DGJ – 9065 dhe ka vërejtur se KEK-u për shkak të dyshimit se njehsori elektrik nr. 2248588 nuk është 5 shifror por është 6 shifror, e ka ngarkuar konsumatorin me datë 24.09.2004 me një ngarkesë financiare prej 3678.40€ (bazuar në procesverbalin nr. 3300 i datës 05.08.2004). Pasi konsumatori ka bërë kërkesë për të dalur në teren punëtorët e KEK-ut dhe ta inspektojnë prapë këtë çështje, dhe se pas konstatimit të KEK-ut se njehsori elektrik nr. 2248588 nuk është 6 shifror por është 5 shifror, me datë 05.10.2004 KEK-u e ka shkarkuar konsumatorin për vlerën prej 3678.40€. Menjëherë pas 2 ditëve (07.10.2004) KEK-u prapë e ka ngarkuar konsumatorin me një ngarkesë prej 598 nën dyshimin se njehsori elektrik nuk ka qenë në rregull dhe se kjo ngarkesë ka rrjedh si rezultat i ngarkesës me paushall nga periudha 07/2002 deri më 08/2004. Pas kësaj prapë KEK-u me datë 04.03.2005 e ka ngarkuar konsumatorin me faturë për rikthim të humbjeve në vlerë prej 868.62 € duke u bazuar në procesverbalin e kalibrimit. KEK-u tek me datë 21.12.2009 ka shkarkuar konsumatorin nga ngarkesa financiare prej 598 €.

Punëtorët e KEK-ut me datë 19.01.2005 me rastin e kontrollimit detal të njehsorit elektrik nr. 2248588 kanë përpiluar procesverbalin nr. 3/19, ku kanë konstatuar se bëhet keqpërdorim përreth qelqit nga ana e djathtë me shirit filmik, qelqi i njehsorit është shtyrë me forcë dhe pastaj është keqpërdor. Punëtorët e autorizuar të KEK-ut po ashtu kanë theksuar se është penguar puna e numëruesit, urat e tensionit janë të dëmtuara dhe se njehsori elektrik është keqpërdor për kohë të gjatë për shumë vite.

Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së dokumentacionit ka vërejtur se KEK-u ka gabuar në ngarkesën e konsumatorit të datës 07.10.2004 në vlerë 598€ duke theksuar se Sektori për konsumatorë nën dyshimin se njehsori elektrik nr. 2248588 nuk ka qenë në rregull (për shkak të faturimit të ulët), dhe se për këtë shkak e ngarkon konsumatorin me një ngarkesë prej 598 €, si rezultat i ngarkesës paushalle (nga periudha 07/2002 e deri më 08/2004). DMK vlerëson se një konstatim të tillë se njehsori elektrik nuk është në rregull mundet të jap vetëm qendra e kalibrimit (sektori i shqyrtimit të



njehsorëve elektrik) e jo sektori i për konsumator, ngase ky sektor mundet vetëm të dyshoj në faturim të ulët dhe të kërkojë të bëhet shqyrtimi i njehsorit elektrik dhe varësisht nga shqyrtimi i njehsorit elektrik edhe bëhet korrigjimi, dhe kjo bëhet sipas nenit 5.11.1 të Kodit të Matjes.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë P.nr. 403/05 të datës 08.02.2008, në të cilin Aktgjykim gjykata e ka shpallur fajtor konsumatorin A. J. për vepër penale nga neni 252 par 1 të KPK-së, dhe e ka dënuar me gjobë në vlerë financiare prej 250€, pasi që i njëjti prej datës së pavërtetuar e gjerë më 05.08.2004 me qëllim që vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, duke i dëmtuar urat e tensionit dhe me ndihmën e shiritit filmik e ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike duke i shkaktuar KEK-ut dëme materiale në vlerë prej 868.62€ dhe e ka udhëzuar KEK-un që për të realizuar kërkesën e vet juridiko pronësore ta realizoi përmes kontestit civil, si dhe Aktgjykimin e gjykatës së Qarkut të datës 14.10.2009 dhe ka udhëzuar KEK-un që për dëmin e shkaktuar ta realizoi përmes kontestit civil me të cilin është refuzuar si e pabazë ankesa e konsumatorit A. J.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe shpenzimin e energjisë elektrike të tre njehsorëve të cilët i ka pasur në funksion konsumatori me shifër DGJ – 9065, nga fillim e deri më 11/2004 konsumatori ka pasur njehsorin elektrik nr. 2248588, pas kësaj prej 11/2004 e deri më 02/2005 ka pasur njehsorin e KEK-ut nr. 7224193, si dhe pas kësaj nga periudha 03/2005 e tutje është vendosur njehsori elektrik nr. 12143220. Mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike nr. 2248588 nga periudha 07/2002 e deri më 11/2004 ka qenë 93 kWh/muaj, mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit të KEK-ut nr. 7224193 nga periudha 12/2004 – 02/2005 ka qenë 281 kWh/muaj, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr. 1214322 nga periudha 02/2005 e deri më 12/20012 ka qenë 353 kWh/muaj. Sipas kësaj analize vërehet se shpenzimi i energjisë elektrike me njehsorin i cili është tani në funksion është rritur për 281% në krahasim me shpenzimin në njehsorin elektrik nr. 2248588 i cili ka qenë në shfrytëzim para se të bëhet ndërrimi i njehsorit elektrik.

Për shkak se KEK-u nuk ka respektuar saktë Gazetën e KSAK-ut e cila ka qenë në fuqi në momentin e faturimit me rikthim të humbjeve dhe se nuk ka marrë me kohë pajisjet elektrike të cilat i posedon konsumatori në shtëpi, atëherë nga KEK-u, duhet që të merr për llogaritje diferencën e shpenzimit të energjisë elektrike mes njehsorit elektrike të parë nr. 2248588 dhe njehsorit elektrik aktual, ku siç u theksuar më lartë mesatarja mujore e shpenzimit të njehsorit nr. 2248588 prej periudhës 07/2002 – 11/2004 ka qenë 93 kWh/muaj, ndërsa mesatarja mujore e njehsorit elektrik nr. 1214322 nga periudha 02/2005 e deri më 12/20012 ka qenë 353 kWh/muaj. Sipas kësaj diferenca mes këtyre dy mesatareve është 260 kWh/muaj, andaj edhe më këtë vlerë KEK-u duhet ta ngarkoj konsumatorin me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike (rikthim i humbjeve) duke u kthyer mbrapa për 6 muaj nga periudha e ndërrimit të njehsorit elektrik.

Bordi i ZRRE-së, ka vlerësuar se parashtruesi i ankesës A. J. në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së, nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana e DMK-së, gjatë nxjerrjes së vendimit, gjithashtu kundërshtimet të theksuara në ankesë kanë shumë kundërthënie njëra me tjetrën, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së pas analizimit të gjitha proceseve të KEK-ut, dhe ankesës së konsumatorit konstaton se Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka vepruar drejt në vendimin e tij.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 22.04.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_916_03_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të



gjitha dëshmime tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar